

## Dërgoni zgjidhjen tuaj të TI-së për “Sharing & Reuse Awards”!

### Konkurs për administratat publike

Komisioni Evropian ju fton të merrni pjesë në konkursin “Sharing & Reuse Awards” të organizuar si pjesë e veprimit “Sharing and Reuse” të [programit ISA<sup>2</sup>](#).

A keni punuar me sukses për dixhitalizimin e shërbimeve publike? A keni zhvilluar një zgjidhje që i përket një prej kategorive të përmendura më poshtë? Ndajeni përvojën tuaj duke dërguar regjistrimin tuaj në këtë konkurs! Administratat publike që kërkojnë zgjidhje specifike të TI-së do të jenë të interesuara për të ditur se si u jeni adresuar sfidave të ngjashme dhe për të mësuar se si të përdorin softuerët me burim të hapur ose shërbimet e ndara të TI-së që keni zhvilluar. Bëjeni të dukshme punën tuaj të shkëlqyer!

Çmimet që do të fitohen janë 15 000 € për ekipin fitues dhe 10 000 € për vendin e dytë në secilën prej këtyre 4 kategorive:

1. Softueri me burim të hapur **më inovativ**
2. Softueri me burim të hapur **me ndikimin më të madh te qytetarët ose bizneset**
3. Shërbimet e ndara të TI-së **më inovative** (të zhvilluara ose të ndara zakonisht)
4. Shërbimet e ndara të TI-së (të zhvilluara ose të ndara zakonisht) **me ndikimin më të lartë te qytetarët ose bizneset**

Ju lutemi lexoni me kujdes [udhëzuesin e procedurës](#) përpara se të plotësoni formularin e paraqitjes. Është e rëndësishme që të jepni të dhëna rreth zgjidhjes suaj të TI-së dhe potencialit të saj për ripërdorim më të gjerë. Edicioni i vitit 2017 i konkursit “Sharing & Reuse Awards” me 118 aplikime ishte një sukses i vërtetë, prandaj shpresojmë që viti 2019 të jetë edhe më i mirë!

#### 1. A ka zgjidhja juaj të drejtën për të marrë pjesë?

Për të marrë pjesë në konkurs, zgjidhja juaj duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme:

- Duhet të jetë zhvilluar nga ose për një administratë publike nga një Shtet anëtar i BE-së, vend i EFTA-s ose vend kandidat i BE-së (Shqipëria, ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë, Mali i Zi, Serbia dhe Turqia).
- Është duke u ripërdorur nga të paktën një administratë publike.
- Është softuer me burim të hapur ose shërbim i ndarë TI-je.
- Përshkrimi i tij është publikuar në Joinup. *(Nëse zgjidhja juaj nuk është ende në Joinup në momentin e regjistrimit të konkursit tuaj, [Ekipi i mbështetjes së Joinup](#) do të jetë në dispozicion për t’ju ndihmuar të publikoni zgjidhjen tuaj).*
- Përshkrimi është dhënë në anglisht.
- Zgjidhjet që kanë marrë shpërblim monetar në konkursin e mëparshëm (S&R 2017) nuk kanë të drejtën të marrin pjesë. Ata që ishin në vendin e tretë ose të katërt dhe morën certifikatë përsosmërie mund të paraqiten nëse i përkasin një prej kategorive.

#### 2. Kriteret e vlerësimit

Zgjidhjet tuaja do të vlerësohen nga një komitet vlerësimi dhe një juri në dy hapa bazuar në kriteret e mëposhtme:

- **Projektimi i zgjidhjes dhe qeverisja:** shkalla në të cilën përdoren dhe/ose respektohen standardet e hapura; niveli i dokumentimit të zgjidhjes dhe cilësia e projektimit; niveli i bashkëpunimit, bashkëpunimi ndërkufitar, bashkëpunimi mes institucioneve dhe identifikimi i një modeli qeverisës që mbështet zgjidhjen.

- **Ndikimi/shkalla e ripërdorimit:** modeli i biznesit të zgjidhjes; realizimi i objektivave dhe aktiviteteve të planifikuara; prova të vërtetuara të përfitimeve (duke përfshirë kursimet e përcaktuara përmes ripërdorimit në vend të zhvillimit nga e para); ndikimi i dukshëm dhe rezultatet e pritshme; kursimet ose rezultatet që mund të realizohen ende; numri i rasteve të ripërdorimit dhe të dhënat e planeve për ripërdorim në të ardhmen dhe përpjekje të vazhdueshme; ripërdorimi i shërbimeve ekzistuese të organizatave të tjera; ripërdorimi i moduleve të aplikacionit nga aplikacione të tjera.
- **Qëndrueshmëria:** shkalla në të cilën zgjidhja shfaq elementet që e lejojnë të jetë e qëndrueshme pasi të arrihen objektivat e saj; shkalla në të cilën është e garantuar qëndrueshmëria; dokumentacioni teknik; dokumentacioni i modelit të biznesit; mirëmbajtja; disponueshmëria e lartë.
- **Inovacioni (për kategorinë 1 dhe 3):** inovacioni teknik; inovacioni i procesit të biznesit; inovacioni social.
- **Mbajtja e përdoruesit në fokus (për kategorinë 2 dhe 4):** aksesueshmëria për qytetarët; të dhënat e personalizuara; shërbimet e personalizuara; njoftimet; pajisjet celulare.

### 3. Mënyra e pjesëmarrjes në konkurs

Për të marrë pjesë në konkurs, duhet të plotësoni [formularin e regjistrimit](#) në internet. Ju lutemi të vini re se regjistrimi në konkurs, çdo dokument mbështetës dhe përkrahje të zgjidhjes duhet të jepen në anglisht. Por, zgjidhja vetë nuk është nevojta të jetë në anglisht. **Afati përfundimtar për regjistrimet është data 28 shkurt 2019.**

Komisioni do të njoftojë 16 zotëruesit e zgjidhjeve të përzgjedhur si kandidatë të mundshëm përmes emailit deri më 25 prill 2019. Përfaqësuesit e tyre do të ftohen në ceremoninë e “Sharing & Reuse Awards” më 11 qershor 2019 në Bukuresht të Rumanisë dhe do t’u jepet mundësia të paraqesin zgjidhjen e tyre.

4. **Ju nevojitet më shumë informacion në lidhje me procesin e regjistrimit? Shkoni te [Versioni i plotë i udhëzuesit të procedurës.](#)**




### 5. Lidhje të dobishme

[Faqja e konkursit në platformën e Joinup](#)  
[Pyetjet e shpeshta \(PESH\)](#)  
[Edicioni i mëparshëm i konkursit](#)  
[Më shumë informacion rreth programit ISA<sup>2</sup>](#)

### 6. Keni pyetje?

Na kontaktoni me email në adresën e mëposhtme:  
[DIGIT-SR-AWARDS@ec.europa.eu](mailto:DIGIT-SR-AWARDS@ec.europa.eu)

### 7. Na ndiqni ne rrjetet sociale

 [@EU\\_ISA2](#) → [#SRawards19](#)  
 [ISA<sup>2</sup> Programme](#)  
 [ISA<sup>2</sup> videos](#)

**JU UROJMË FAT!**